



PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN “QENDËR SHËNDETËSORE”

(Veprimtari te tjera", 12.3, Institucionet shëndetësore.
sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në
ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)



Subjekti: NJ.V.K.SH Elbasan

Hartoi : LOERMA SH.P.K



BAZA LIGJORE

- Ligji Nr. 1 O 431, date 09.06.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit"
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit"
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 "Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara"
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta"
- Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja"
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve"
- Vendim nr. 805 date 4.12.2003 "Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore"
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 "Per largimin publik te mbeturinave"
- Udhezim nr. 1 date 03.03.2009 "Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis"
- Udhezim nr. 3 date 19.11.2009 "Per metodologjine e raportit te VNM"
- VKM nr.419 date 25.6.2014 "Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesisheme per shqyrtimin e tyre nga autoritete kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja"
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013" Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis".

Subjekti "Nj.V.K.Sh Elbasan" është i pajisur me leje mjedisore Tipi C, me veprimtari "**Ambulancat, spitalet ditore pa shtreter, poliklinikat dentare me mbi 3 poltrona, labororet mjekesore dhe dentare.**"

dhe Referuar shtojcës 1 te ligjit 52/2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR", aktiviteti QENDER SHENDETESORE , klasifikohet për tu pajisur me Leje Mjedisi te tipit B;

"Veprimtari te tjera", 12.3 Institucionet shëndetësore. Kapaciteti kufi per lejet e tipit B: Çdo prodhues i mbetjeve spitalore i cili prodhon më shumë se 200 kg/vit mbetje spitalore të rrezikshme.


Aktivitetet për të cilat kërkohet të merret leje mjedisi, nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësorë Elbasan, kanë të bëjnë me veprimtarinë apo aktivitetet që kryhen në :

- 1) Laboratorin e analizave bakteriologjike.
- 2) Laboratorin e analizave fiziko – kimike.
- 3) Shërbimin stamatologjik për institucionet shkollore dhe parashkollore.

1.1. PËRSHKRIMI I VENNDODHJES DHE I RREJTEVE INXHINJERIKE.

Laboratori i analizave bakteriologjike dhe ai i analizave fiziko-kimike, janë të instaluar në një godinë ndërsa shërbimi stamotologjik është i instaluar në një godinë tjetër tjetër, në një distancë që nuk kalon 50 m në largësi në vijë ajrore.

Të dy godinat janë ndërtuar në bazë të vendimeve dhe legjislacionit përkatës të më shumë se 40 viteve më parë dhe, vijojnë të kryejnë të njëjtat veprimtari. Projekti ndërtimor si dhe rrjetet inxhinjerieke të tyre janë konceptuar dhe realizuar duke patur parasysh, qëllimin për të cilin ato të shërbenin. Në këto vite ato janë rikonstruktuar nga pikpamja ndërtimore si dhe janë plotësuar me aparatura e pajisje bashkëkohore. Të dy godinat janë tre katëshe, në hapsirat respektive të të cilëve janë instaluar laboratorët përkatës dhe disa ambiente pune për personelin dhe administratën.



Të dy godinat e kanë pamjen e tyre kryesore nga perëndimi, duke u lidhur drejtpërsëdrejti me Rrugën “28 Nëntori” . Ato gjenden rreth 50 m në jug të kryqëzimit të kësaj rruge, me Rrugën “Qemal Stafa”.

Janë lehtësisht të gjetëshme nga komuniteti i interesuar për shërbimet që ato afrojnë.

Godinat janë të lidhura me rrjetet inxhinjerieke të kësaj rajoni të qytetit të Elbasanit.

Në bazë të kontratës së lidhur me operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike, bëhet furnizimi i sejcilës godinë me energjinë e nevojshme. Energjia elektrike shpërndahet tek përdoruesit sipas një rrjeti të brendshëm i plotësuar me pajisjet e nevojshme, në bazë të projekteve elektrike të çdo godine. Të dy këto rrjete të brendshme kanë edhe sistemin e tyre të tokëzimit, duke siguruar kështu një mbrojtje të këtyre rrjeteve dhe pajisjeve që ato furnizojnë nga mbingarkesat elektrike.

Uji i pijshëm merret nga rrjeti i zonës, në bazë të kontratës me subjektin që ka në administrim këtë rrjet si dhe rrjetin e kanalizimeve për ujrave të zeza dhe ato të bardha.

Shpërndarja e ujit tek konsumatorët e brendshëm të këtyre veprimtarive bëhet nga rrjeti i brendshëm i ndërtuar sipas projekteve të hartuar për çdo godinë.

Po kështu edhe largimi i ujrave të përdorur, bëhet nga rrjetet e brendshëm që marrin ujrave nga çdo pikë përdorimi dhe me anë të kolektorëve të çdo godine i shkarkojnë ato në kolektorin përkatës të zonës.

Në hapsirat e laboratorëve, koridore etj. Të të dy godinave janë vendosur fikse zjarri të mbushura me gaz ose pluhur, me vëllim 6 litra.

1.2. PËRSHKRIMI I VEPRIMTARIVE.

1. Laboratori i analizave bakteriologjike.

Nga personel i kualifikuar dhe me një eksperiencë pune disa vjeçare, këtu kryhen këto lloj analizash bakteriologjike :

- a) KOPROKULTURË Mbjellje në teren b.c
- b) HEMOKULTURË Mbjellje në bujon ushqyes;
- c) UROKULTURË Mbjellje në teren EMBO;
- d) AJROGEN TEST Mbjellje në teren Agar – Gjak;
- e) TESTE SEROLOGJIKE Widal, Wright, Weil- Felix;

- f) Analiza Mykore Mbjellje në teren Saburo
- g) Analiza Micelare Preparat nativ;;
- h) Analiza Parazitare Preparat nativ;

- i) Analiza ushqimore Mbjellje në teren ushqyes;
- j) Përcaktim steriliteti Mbjellje në teren ushqyes;
- k) Analizë serologjike Virale Raport test Ag,HCV, Sifiliz, HIV

- l) Antibioگرامe dhe Mykogramme Disqe AB dhe antimykokit

Gjatë kryerjes së analizave të përshkruara më lart, krijohen mbetje të natyrave/llojeve të ndryshme ndër të cilat vlen të përmendim :

- ❖ Mbetje të analizave të feçeve;
- ❖ Mbetje të analizave të urinës;
- ❖ Rapid-Test në pllaka plastike
- ❖ Reagentë kimik të cilëve u ka kaluar afati i përdorimit.

Të gjitha këto lloje mbetjesh, futen në kontenjerët përkatës dhe magazinohen për disa ditë, në një ambient të veçantë në godinën e DRSH, deri në marrjen prej tyre nga Subjektit “MEDI TEL” sh.p.k. me NIPT J71519004W dhe administrator z. Anastas Peçini. Të dy subjektet kanë nënshkruar mes tyre një kontratë bashkëpunimi, me objekt : **“Grumbullimin, transportin, trajtimin e mbetjeve spitalore të rrezikëshme, duke përjashtuar mbetjet me rrezik kimik dhe radioaktiv”**



Për kryerjen e të gjitha llojeve të analizave të përshkruar më lart, në këtë laborator janë instaluar këto pajisje :

- Aero Steril I TIPI MLW ;
- Aero Steril TIPI STE 90;
- Aero-Steril TIPI PANACEA 2430;
- Mikroskop I TIPI SFC-18;
- Mikroskop TIPI BIO2;
- Termostat TIPI PANCEA;
- Termostat TIPI M780;
- Centrifugë TIPI d7953;
- Centrifugë TIPI 083-039
- Centrifugë TIPI 800;
- Autoklavë sterilizimi TIPI AHS-75H;
- Autoklavë TIPI LS-C506;
- Aparat tundës TIPI sa 8;
- Aparat Shunjer magnet TIPI 1000;
- Peshore analitike ;
- Flux laminar;
- Box paraziti;
- Distilator TIPI GFL;
- Aparat vakumi ;
- Aparat membrane filtri TIPI ROCKER 400;



2. Laboratori i analizave fiziko - kimike.

Nga personel i kualifikuar dhe me një eksperiencë pune disa vjeçare, këtu kryhen këto lloj analizash fiziko -kimike :

- a. Analizat fiziko-kimike të ujit të pijshëm të qytetit Elbasan dhe të fshatrave përreth si dhe të lumenjve.
- b. Matjes e përqindjes së hipokloritit që përdoret në klorifikimin e ujit.
- c. Analizë e kripës së jodizuar.
- d. Matje e mikroklimës, zhurmave, gazeve në ambientet e punës në nivelin e frymëmarrjes së punëtorit.

Të gjitha analizat e përshkruara në gërmat a,b dhe c kryhen në ambientet e këtij laborator, ndërsa ato të përshkruara në gërmën d, bëhen në ambientet e punës të subjekteve prodhues. Analizat e vlerësimit të mikroklimës, etj në zbatim të programit të punës të këtij institucioni por edhe për vlerësimin e kërkesës së subjektit për t'u pajisur me leje higjene, në bazë të legjislacionit përkatës.



Për kryerjen e të gjitha llojeve të analizave të përshkruara më lart, në dispozicion të specialistëve të këtij laborator janë pajisjet e listuara në vijim :

- Monitor gazi;
- Spektometër;
- Aparat AQS;
- Aparat Multi media
- Sonometër
- Konduktometër TIPI INOLAB CONO 720
- Drager dore + ampula
- Distilator TIPI TIP 200 U
- Spektofotometër TIPI 6100 VS
- Aparat matje klori
- pH metër TIPI 60 UV;
- Termostat TPI 2001 IU;
- Refraktometër;
- Polarimetër;
- Termoleometër;
- Termometër senkop
- FEK
- Peshore elektrike TIPI AE240S

- Kapë dhe aspirator thithës.
- Fotoklorimetër
- PhotoLab 6100 VS
- Sanometër testo 815
- Matës gazi MSA ORION
- Matës pluhurash ESCORT ELF PUMP;
- Konduktometër INO LAB 720



Është e rëndësishme të theksojmë se në të dy ambientet e laboratorëve, nuk lejohet të futen njerëz të paautorizuar. Kampionë të ndryshëm që vijnë për t'u analizuar nga institucione shtetërore, subjekte private etj. merren nga personel i caktuar dhe në një vend të caktuar, duke zbatuar të gjitha kërkesat ligjore respektive për etiketimin, evidentimin dhe ruajtjen e tyre.

3. Shërbimi stomatologjik.

Shërbimin stomatologjik për institucionet shkollore dhe parashkollore, kryhet në godinën egzistuese të këtij shërbimi për qytetin e Elbasanit.

Në këtë klinikë punon një personel prej 13 personash, që janë specialistë të stomatologjisë dhe të specializuar në fusha të ndryshme të shërbimit të stomatologjisë. Ky personel afron shërbimin e tij, në bazë të programeve dhe marrëveshjeve me drejtoritë e shkollave apo edhe në paraqitjen e fëmijëve të shoqëruar nga prindërit e tyre.

Këtu kryhen kontrole të dhëmbëve, ndërhyrje mjeksore për normalizim gjendjes së tyre, mjekime, dhe këshilla për kujdesin ndaj dhëmbëve.

Në dispozicion të specialistëve përkatës dhe të pacienëve janë instaluar disa poltrona dentare me të gjitha pajisjet e nevojshme të shërbimit dentar. Këtu duhet të përmendim edhe pajisjet për dizinfektimin e mjeteve të punës të personelit mjeksor në ndihmë të pacientëve.

Gjatë ushtrimit të këtij shërbimi stomatologjik, krijohen mbetje spitalore të klasifikuara tek mbetjet e rrezikëshme ndër të cilat mund të përmendim:

- ❖ Aget dhe shiringat një përdorimshe;
- ❖ Bisturitë;
- ❖ Tamponët e pambukut;
- ❖ Dorezat dhe gushoret plastike;
- ❖ Ambalazhet prej qelqi të medikamenteve të përdorur
- ❖ Etj.

Të gjitha llojet e mbetjeve spitalore, ambalazhohen në kontenjerët plastikë të sjellë nga Subjekti "MEDI-TEL" sh.p.k. dhe magazinohen në një ambjent të caktuar të kësaj godine. Këto mbetje merren nga subjekti "MEDI-TEL" sh.p.k. sipas një grafiku të caktuar në marrëveshjen përkatëse.

Nga të gjithë aktivitetet e përshkruara, krijohen edhe mbetje të ngurta si ambalazhe plastike, letre/kartoni, qelqi, mbetje ushqimore etj. Të gjitha këto lloj mbetjesh përfshihen në mbetjet e ngurta urbane dhe largohen çdo ditë nga personel i caktuar, duke u dërguar në kazanët e mbetjeve urbane të zonës së banuar.